



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 159, datë 14.04.2021

PËR
DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR GJYQTARES {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenin 24, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 25 pika 3 shkronja “d” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dhe Vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën e gjyqtares {...} me nr. 1368 prot., datë 31.03.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 3 mujore, e cila fillon në datë 20.04.2021.
2. Rindarjen me short të gjitha çështjeve që gjyqtarja {...} ka në shqyrtim në momentin e fillimit të lejes së papaguar.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR